



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 26.09.2016,  
e cila filloi në orën 15:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Mirlinda Sopi shefe e GP të AKR-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

**Të pranishëm ishin edhe:** Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Gent Begolli, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Osman Bllaca.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

**Për këtë mbledhje u propozua ky**

### **REND I DITËS:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2017 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2017-2019;**
- 3. Propozimrregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme;**
- 4. Propozimrregullorja për menaxhimin e mbeturinave;**
- 5. Plani për menaxhimin e mbeturinave 2016-2020;**
- 6. Propozimvendimi për dhënien e pronës se paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Zyrës së Bashkimit Evropian;**
- 7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë;**
- 8. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin përfundimtar për kërkesën e grupit të qytetarëve të lagjes “Prishtina e Re” – Zona Perëndim;**

9. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit 01, nr. 031-52761, dt.04.03.2016, për dhënien e pëlqimit për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës "F - F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2" në lagjen "Lakërishta" në Prishtinë;
10. Propozimvendimi për anulimin e Aktvendimit 07, nr. 463-651/98, dt.19.09.1998, të Komisionit për kthimin e tokës së Kuvendit të Qytetit të Prishtinës;
11. Raportimi i komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale;
12. Të ndryshme.

**Për rendin e ditës diskutuan :**

**Dardan Sejdiu, nënkryetar,** sugjeroi që kërkesa e Zyrës së Bashkimit Evropian për dhënien e pronës se paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim, nëse është e mundur të jetë pas pikës së buxhetit në mbledhjen e Kuvendit.

**Mirlinda Sopi** u interesua për kërkesën e familjes Pacolli lidhur me heqjen e emërimit të një rruge në Hajvali, e cila është në emër të familjarit të tyre. Ajo pyeti se kjo kërkesë a duhet të përcillet si pikë e rendit të ditës e të diskutohet, apo mundë të diskutohet në pikën "Të ndryshme" në mbledhjen e Kuvendit.

**Halim Halimi, kryesues,** dha sqarime lidhur me këtë, duke thënë se komisioni për emërtime është shuar dhe ne duhet të formojmë komisionin për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave. Ai propozoi që në mbledhjen e Kuvendit, e cila do të mbahet më 29 apo 30 shtator, të futet si pikë e rendit të ditës: "Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe rrugicave".

**Qëndron Kastrati** bëri të ditur se kërkesa lidhur me emërtimet, gjegjësisht punën e këtij komisioni, ka pasur edhe nga Brahim Mehmetaj dhe Sadri Ramabaja.

Ai propozoi që të konsultohen me anëtarët e atij komisionit ose Zyrën ligjore, të shihet si është e paraparë kjo çështje dhe të trajtohen të gjitha pakënaqësitë e shprehura nga të gjitha grupet, por nuk e përkrahim që të futet menjëherë si pikë e rendit të ditës.

**Mirlinda Sopi** tha se meqë e kemi Zyrën ligjore, presim udhëzimet për hapat e mëtejme.

**Brahim Mehmetaj** e mbështeti këtë për ta kontestuar si proces, por jo si individ, sepse nuk është kryer puna si duhet nga komisioni.

**Halim Halimi, kryesues,** theksoi se mund ta formojmë komisionin, i drejtojmë kërkesat, komisioni i shqyrton dhe ia prezanton Kuvendit, pastaj Kuvendi vendos.

Zyra ligjore të merret me këtë çështje dhe të na japë interpretimet e duhura në Kuvend.

**Laura Zherka** kërkoi sqarime lidhur me pikën e 11-të, te raportimi i komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale, se prej cilëve aksionarë janë përgatitur raportet, sa aksionarë kanë marrë pjesë në përgatitjen e raporteve dhe cilat raporte na kanë ardhur.

**Halim Halimi, kryesues,** dha sqarime, duke thënë se komisionet e aksionarëve që nga fillimi nuk janë në përbërje të plotë, diku nuk kanë pasur as qasje, nuk kanë mund t'i përgatisin raportet, disa nuk janë raporte të aksionarëve por të bordeve. Raportet e komisioneve të aksionarëve nuk i plotësojnë kushtet e raporteve të aksionarëve.

**Lirak Çelaj** tha se është dashur të informohemi me kohë për t'i përgatitur raportet, për parking nuk e kam përgatitur, sepse nuk kam qenë i informuar, por do ta përgatis.

**Qëndron Kastrati** tha se për neve nuk ka komisione komunale të aksionarëve funksionale, përveç dy ndërmarrjeve ku janë të përfaqësuara dy palët, Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës, ndërkaq ne nuk mund të bëjmë raport funksional përderisa komisionet komunale aksionare nuk janë funksionale.

**Halim Halimi, kryesues,** propozoi që të dërgohen në Kuvend kështu siç janë, sepse dihet si është gjendja e komisioneve komunale të aksionarëve, po shihen se këto nuk janë raporte të aksionarëve, as që u ngjajnë raporteve të komisioneve të aksionarëve. Ne të marrim qëndrim çka të bëjmë, ose të flasim për një mbledhje të ardhshme, ku do të sillen komplet raportet e komisioneve të aksionarëve.

**Hazir Borovci** theksoi se pika e rendit të ditës është e qartë: “Raportimi i komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale”. Këtë çështje nuk e zgjidh as nënkryetari, as ne, këtë çështje e zgjidh ligji. Ligji është ai që e rregullon këtë çështje: duhet të raportojë bordi, raporton bordi; duhet të raportojë komisioni komunal i aksionarëve, raporton komisioni i aksionarëve. Këto raporte nuk kanë të bëjnë fare me raportet e komisioneve të aksionarëve, këto janë të bordeve të aksionarëve. Zyra ligjore le të na japë informacione lidhur me këtë çështje.

**Mirlinda Sopi** tha në seancën e fundit është kërkuar që të raportojnë aksionarët, e para, sepse e kanë obligim ligjor me raportuar dhe, e dyta, është kërkuar në seancë që në seancën tjetër të raportojnë aksionarët e ndërmarrjeve.

**Brahim Mehmetaj** shprehu mendimin se është shumë e nevojshme që të diskutohet për ndërmarrjet, rreth zhvillimit të tyre, problemeve të komisioneve të aksionarëve, që ne të gjejmë formulën që në këtë mbledhje të diskutojmë. Duhet të diskutohet sepse gjendja në ndërmarrje komunale është e vështirë, kjo është shqetësuese për qytetarët dhe për ne, andaj është me rëndësi të diskutohet dhe të futet në rend të ditës.

**Laura Zherka** shprehu habi se si mund të hartohet raport kur nuk ka qasje në ndërmarrje, dhe pyeti se cilat raporte janë përpiluar prej komisioneve të aksionarëve që janë legjitime.

**Halim Halimi, kryesues,** u shpreh se asnjëri prej raporteve nuk i plotëson kushtet për të qenë raport i komisionit aksionar.

**Dardan Sejdiu, nënkryetar,** theksoi se raporti është obligim ligjor. Prej këtij obligimi ligjor delegon edhe përgjegjësia që e marrin ata që janë votuar me qenë aksionarë në ndërmarrje publike. Materialet që kanë ardhur nuk janë asnjëra raporte të komisioneve të aksionarëve, mirëpo aksionarët janë në Kuvend, janë të deleguarit e Kuvendit komunal, që janë të përfaqësuar nga Kuvendi, prej tyre po kërkojmë raporte.

**Lirak Çelaj** u shpreh se është me rëndësi se si fillon ky debati. Këtu po kontestohet legjitimiteti i ndërmarrjeve publike. Ne jemi për të debatuar për ndërmarrjet publike, ne po kërkojmë të na jepet afat në përgatitjen e raporteve të komisioneve të aksionarëve dhe të jenë raporte të aksionarëve e jo të bordeve.

**Dardan Sejdiu, nënkryetar,** theksoi se Liraku sugjerimin e vetë le ta paraqesë në Kuvend, e si sugjerim i tillë mund të vendoset me vota për ose kundër sugjerimit, pra puna është se a të vazhdohet me diskutim, apo të raportojnë ata që janë deleguar nga Kuvendi i Komunës.

**Halim Halimi, kryesues,** u pajtua që kjo të përcillet për Kuvend, pastaj Kuvendi vendos për ta shtyrë këtë pikë të rendit të ditës edhe për një kohë, derisa të hartohen raportet e komisioneve aksionare.

**Njëzëri u miratua rendi i ditës.**

## **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa .**

**Mirlinda Sopi** kërkoi që në të ardhme, për secilën pikë të ceket secili diskutues dhe të jepen diskutimet në pika të shkurta.

**Me vërejtjen e dhënë, Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Pika e dytë**

**Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2017 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2017-2019.**

**Halim Halimi, kryesues,** bëri të ditur se ekzekutivi i Komunës pas dëgjimeve publike, e ka sjellë propozimbuxhetin në zyrën e Kuvendit, mirëpo në ndërkohë i ka bërë edhe disa ndryshime dhe tani ju e keni materialin në versionin e fundit.

Ky propozimbuxhet i Komunës së Prishtinës për vitin 2017, sa i përket shumës, pothuajse është identikë me buxhetin e vitit 2011, d.m.th. 62,023,630 € janë të parapara për vitin 2017 në Komunën e Prishtinës. Ky buxhet është vështirë të quhet buxhet zhvillimor i Komunës së Prishtinës, ngase nuk shihet dhe këto paralajmërime kanë qenë edhe më herët se Komunës së Prishtinës është duke iu zvogëluar buxheti.

**Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave,** dha sqarime lidhur me propozimbuxhetin e vitit 2017. Të gjithë kufijtë buxhetor na vijnë nga qarkorja buxhetore, ata janë kufij buxhetorë që i ka caktua Ministria e Financave. Në bazë të kufijve buxhetorë jemi përpjekur ta mbajmë secilën vijë buxhetore, i kemi shpjeguar secilën pikë veç e veç, granti i përgjithshëm, granti specifik, të hyrat vetjake, pra këto janë të caktuara në bazë të qarkores buxhetore. Ne i kemi limitet dhe në bazë të limitit duhet punuar buxheti.

**Hazir Borovci** tha se për përmbajtjen e propozimbuxhetit të vitit 2017 do të diskutojmë më gjerësisht në Kuvend, baza ligjore është, procedurat e përgatitjes së buxhetit po, zhvillim jo, në buxhet flasin numrat, te planifikimi i shpenzimeve janë numrat ata që i tregojnë rezultatet si të viteve 2010, 2015 dhe 2016.

**Qëndron Kastrati** shprehu shqetësimin për trajtimin e Prishtinës sipas numrit të banorëve, në bazë të regjistrimit të popullsisë. Kjo është shumë e padrejtë, sepse ne e dimë që në komunën e Prishtinës nuk trajtohen vetëm qytetarët e Prishtinës, por ka edhe shumë kategori që nuk janë të regjistruara, jetojnë dhe i marrin shërbimet prej komunës së Prishtinës. Shpresojmë se me miratimin e Ligjit për Prishtinën mund të zgjidhet ky problem.

Ai kërkoi nga Qeveria që të jetë më kreative, në mënyrë që të gjejë mundësi të tjera të arkëtimit të buxhetit të Komunës së Prishtinës.

**Laura Zherka** kërkoi sqarime te shpenzimet për shërbime, ku vlera është 600.000 €, të specifikohet kjo shumë. Te projektet me bashkëfinancim, cilat projekte janë në pyetje te shpenzimet kapitale, shuma prej 50.000 € duket se është shumë e vogël. Te Drejtoria e Infrastrukturës, projektet me bashkëfinancim, për cilat projekte është fjala, kërkojmë sqarim. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në lagjet e reja, shuma prej 400.00 € është e vogël, sepse Prishtina ka nevojë më shumë.

Ndërtimi i mureve ekzistuese kundër rrëshqitjes së dheut, vërshimet, a është fjala për lagjen "Arbëria", apo më tepër, edhe kjo shumë prej 50.000 € është e vogël. Te Drejtoria e Pronës,

shpronësimet, të ceket për cilat shpronësime është fjala. Te Drejtoria e Kulturës, pse nuk është ndërtimi i stadiumit të Prishtinës? Te projektet me partneritet publiko-privat, kërkoj sqarim se cilat projekte i posedon Komuna e Prishtinës.

**Dardan Sejdiu, nënkryetar,** u përgjigj lidhur me pyetjen për stadiumin e Prishtinës, duke thënë se ndërtimi i stadiumit është dhënë te Drejtoria e Investimeve Kapitale, faqe 4, pika 11.

**Mirlinda Sopi** u shpreh e pajtimit me propozimin e z. Kastrati, që të gjenden mundësi të tjera të arkëtimit të buxhetit të Komunës së Prishtinës.

Sa i përket ndërtimit të Qendrës për persona me nevoja të veçanta, te planifikimi për buxhetin e ardhshëm, i është ndryshuar emri, tash po e shoh se dedikohet për personat me Syndrom Down dhe Autizëm. Dua ta dijë se a është destinuar vetëm për këto dy kategori, Syndrom Down dhe Autizëm, apo kanë me pasur qasje të gjitha kategoritë e personave me nevoja të veçanta në këtë qendër. Komuna e Prishtinës do të bënte një diskriminim të madh po që se do ta destinonte një qendër të vetme në qytet vetëm për Syndrom Down dhe Autizëm, sepse do t'i favorizonte vetëm këto kategori. Pra, kërkoj sqarime pse është ndryshuar dhe çka po ndodhë me këtë qendër.

**Brahim Mehmetaj** tha se në Kuvend do të diskutojmë lidhur me buxhetin, edhe ne i kemi disa vërejtje që do t'i paraqesim. Kemi një shqetësim të madh lidhur me raport, me Qeverinë e Kosovës, se si po sillet me qytetin e Prishtinës në aspektin e buxhetit dhe në fusha të tjera.

Kërkojmë nga kolegët që janë partnerë në qeverisje që ta ushtrojnë ndikimin e tyre në qeverisje, që sa më parë ta miratojnë Ligjin për Prishtinën.

**Halim Halimi, kryesues,** kërkoj që formulimi i vendimit të bëhet në formën juridike, të shikohet propozimvendimi dhe të korrigjohet preambula e vendimit, njëherësh edhe në hyrje të buxhetit e kemi viti 2016, është gabim teknik.

**Dardan Sejdiu, nënkryetar,** e falënderoi kryesuesin për vërejtjen e bërë sa i përket preambulës. Ai e sugjeroi shefin e Zyrës ligjore që t'i konsultojë vendimet e viteve të kaluara nëse ka ndonjë gabim ligjor dhe të sigurohet se vendimet janë në përputhje me ligjin si në aspektin përmbajtjesor, ashtu edhe në aspektin teknik. Nëse në aspektin përmbajtjesor nuk ka, por në aspektin teknik ka, të sigurohet që këto sugjerime që i dha kryesuesi të inkorporohen, mirëpo mua dhe kryetarit na duhet një sqarim se a ka lëshime ligjore në hartimin e vendimit. Nëse nuk ka ndonjë lëshim, atëherë jemi dakord për pjesën teknike dhe shtesat që do të bëhen.

Sa i përket buxhetit, ai dha sqarime, duke thënë se buxheti i vitit 2017 është buxhet, i cili në aspektin e sasisë monetare është në dispozicion të Komunës së Prishtinës, është më i vogël se në vitin paraprak dhe dy - tri vitet e kaluara. Komuna e Prishtinës është e vetmja komunë që 45% e buxhetit i shkon për paga dhe mëditje, kështu që mbi 55% të buxhetit shkon për aktivitete që lidhen për mallra dhe shërbime, investime kapitale etj. Komunat nuk mund të kenë buxhet zhvillimor, komunat mund të kenë buxhet që japin shërbim më të mira për qytetarë. Në komunën e Prishtinës kemi bërë investime në vitet e fundit, duke përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve dhe ky trend do të vazhdojë edhe në vitin 2017. Mungesa e Ligjit për Prishtinën po paraqet pengës në arkëtimin e të hyrave.

Buxheti që nga viti 2017 është 62,023,630 €. Kjo shifër buxhetore mund të mos arrihet si arkëtim për të hyrat vetjake, sepse Komuna e Prishtinës, si e vetmja komunë që e ka zbatuar Ligjin për legalizimin në tërësi, po ndëshkohet për shkak të moszbatimit të Ligjit për legalizim.

**Kryesuesi konstatoi se me vërejtjet e bëra, njëzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2017 dhe shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2017-2019, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

### **Pika e tretë**

**Propozimrregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme.**

**Dardan Sejdiu, nënkryetar,** tha se Propozimrregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme është votuar vitin e kaluar. Versioni që e kemi tani është versioni që janë bërë korrigjime dhe shtim të rrugëve të reja. Përmbajtja e kësaj rregulloreje përveç tri faqeve të para, pjesa tjetër nuk ndryshon nga rregullorja e kaluar.

**Ismail Kokaj** tha se mungesa e disa rrugëve që kanë qenë në rregulloren e vjetër, janë futur edhe ato rrugë që kanë qenë në rregulloren e vjetër pa emër, është dashur me iu bashkëngjitur rrugës tjetër kryesore, automatikisht qytetari ka hyrë në zonën më të shtrenjtë, kemi shkuar në detaje që secila rrugë ta ketë tarifën e vetë.

**Qëndron Kastrati** shprehu shqetësimin e tij lidhur me propozimrregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme. Më herët është dhënë propozimin për lirim të një kategorie në tatimin në pronë, ajo nuk është përfshirë në rregullore edhe pse janë dakorduar në Kuvend. Në kuadër të kësaj, këtë rregullore nuk do ta votojmë pa u respektua dhe zbatuar Ligji për kategorinë e dalë nga lufta.

**Laura Zherka** përkrahu dërgimin e propozimrregullores në Kuvend, mirëpo meqë është votuar njëherë dhe kemi marrë vërejtje të shumta nga qytetarët, nuk mund të them se do ta votojmë këtë rregullore.

**Brahim Mehmetaj** u shpreh se përveç asaj që tha z. Kastrati për kategorinë e personave për lirim nga tatimi në pronë, unë kam shqetësim në formën e arkëtimit të mjeteve rreth disa shitblerjeve që bllokohen vërtetimet ( transaksioni ), çështje që shqetëson qytetarët.

**Hatixhe Hoxha** pyeti drejtorin e financave se a ka ndryshuar ky kategorizim.

**Ismail Kokaj** dha sqarime lidhur me pyetjen e znj. Hoxha dhe shqetësimet e z. Mehmeti.

**Halim Halimi, kryesues,** bëri të ditur se ka shumë ankesa nga qytetarët lidhur me këtë rregullore. Nëse kjo është në interes të qytetarëve, atëherë është dashur të debatohet me qytetarë dhe vërejtjet e marra të inkorporohen.

**Dardan Sejdiu, nënkryetar,** theksoi se qytetarët kanë pasur të drejtë të bëjnë ankesë me shkrim. Çdo ndryshim për dikë është i mirë e për dikën jo, mirëpo të gjitha ankesat me shkrim janë trajtuar dhe ato që kanë qenë të pranueshme janë përfshirë në rregullore.

Kjo rregullore në thelb është e mirë, por ka nevojë për korrigjim në bazë të vërejtjeve të qytetarëve.

**Ardian Olluri** u shpreh se Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme, nuk janë të përpunuara nga Zyra ligjore, sepse kanë ardhur me vonesë. Sa i përket lirimit nga tatimi, përmbajtjen e cakton drejtori. Neve nuk na ka ardhur kjo kategori për me e liruar, nëse Komiteti vendos sot për këtë, ne do ta inkorporojmë në rregullore. Mirëpo me ligj janë të liruar, duke u bazuar në kritere të caktuara, ne kemi marrë një interpretim, edhe nëse nuk përfshihen në rregullore kategori të caktuara që janë të liruar me ligj special, mund të bëni kërkesë për t'u liruar në bazë të kritereve.

**Halim Halimi, kryesues,** kërkoi ta dijë se a është e paraparë me ligj që të lirohen kategoritë e dal nga lufta, nëse po, pse mos të jenë në rregullore, nëse jo, ne nuk mund të veprojmë kundër ligjit.

**Brahim Mehmetaj** shprehu mendimin se kjo është specifikë që mund të vendosë vetë Kuvendi i Komunës pa e bërë ligji nacional specifik, sepse komunat tjera e kanë rregulluar. Komuna e Prishtinës duhet të bëjë diçka në këtë drejtim dhe të bëjë diçka për këtë kategori.

Ai propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet, nëse nuk është urgjente, për ndonjë seancë të ardhshme, të merren udhëzime dhe të vendoset.

**Hazir Borovci** theksoi se kur parashihet me ligj, për kategoritë e dala nga lufta duhet të bëjmë çmos. Edhe nëse nuk parashihet me ligj, përmes Zyrës ligjore të jepen udhëzimet që të bëhet diçka për këto kategori.

**Ardian Olluri** tha nëse ju në Komitet jeni që të përfshihet në rregullore, ne e përgatisim për Kuvend.

**Agim Salihu** sqaroi, duke cekur që të zbatohet drejtpërdrejt ligji për këtë kategori, të mos figurojë në rregullore, por të jetë si e tillë, ne mundë ta përfshijmë në rregullore te neni 6.1 dhe në raste të tjera të parapara me ligj, që ne pastaj përmes drejtorit të bëjmë lirimin nga tatimi në pronë.

**Dardan Sejdiu, nënkryetar,** kërkoi që të diskutohet me Kryetarin dhe Zyrën ligjore se si të veprohet më tutje.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme që të përcillet në Kuvend, ndërsa Zyra ligjore bashkë me Kryetarin, të sqarojnë për këtë çështje se a ka mundësi të përfshihet në rregullore nëse jo, atëherë të mbetet kështu dhe t'i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

**Pika e katërt**

**Propozimrregullorja për menaxhimin e mbeturinave.**

**Pika e pestë**

**Plani për menaxhimin e mbeturinave 2016-2020.**

**Dardan Sejdiu, nënkryetar,** dha sqarime për këtë rregullore, duke thënë se Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe azhurnimi i planit të menaxhimit të mbeturinave, janë tema në të cilat kemi punuar mbi 6 muaj. Rregullorja është në përputhje me ligjin dhe është kërkesë ligjore që duhet ta kemi dhe të funksionojmë sipas këtij ligji, ndërsa Plani i veprimit të

menaxhimit të mbeturinave 2016-2020, e ka planin e veprimit me të gjitha objektivat, programet, është dokument i duhur dhe i mirë për Komunën e Prishtinës.

**Laura Zherka** u shpreh e pajtimit se është dokumente i mirë si rregullore, e cila është mbështetur në Ligjin për menaxhimin e mbeturinave. Ajo kërkoi që këto projekte që figurojnë në tabelë të veprimit, sidomos te plani i azhurnimit, te plani i menaxhimit të mbeturinave, të përfshihet në planin buxhetor ndonjë projekt, siç janë të cekura te plani i veprimit. Do të duhej përfshirë te neni 8, detyrimet e gjeneruesve të mbeturinave; te pika 3, me filluar me të gjitha institucionet klasifikimin e mbeturinave, duke klasifikuar letrën, qelqin edhe mbeturinat e papërpunuara, të fillohet nga Komuna dhe të vazhdohet me lokalet publike. Te neni 12, veprimet e ndaluara, të shënohen edhe gjobat të parapara sipas Ligjit për mbeturinat, në mënyrë që të dihet sa është vlera e kësaj gjobe për secilën ndalës.

Ajo kërkoi që te veprimet e ndaluara në rregullore, Zyra ligjore t'i paraqesë gjobat sipas Ligjit për menaxhimin e mbeturinave.

**Halim Halimi, kryesues,** tha se neni 13, dispozitat ndëshkuese, gjobat i parasheh të rregullohen sipas udhëzimit administrativ, ku janë të përcaktuara. Ndoshta mund të futet shtesë në rregullore udhëzimi administrativ, nëse Zyra ligjore e parasheh se nuk është ngarkesë.

**Hazir Borovci** kërkoi të analizohet se a ka nevojë me qenë nenin 2, përkufizimi është i dhënë në ligj, andaj nuk ka nevojë të jetë neni 2. Po ashtu duhet të shikohen nenin 9 dhe nenin 10.

**Laura Zherka** theksoi se te neni 8.3 a) të jetë: “duhet pasur së paku tre kontejnerë” e jo dy kontejnerë.

**Halim Halimi, kryesues,** u shpreh se kjo rregullore ka qenë në diskutim publik, është punuar në bashkëpunim me GIZIN, unë nuk kam vërejtje, por nëse ka mundësi, kërkoj që në hyrje të bëhet diçka në planin e veprimit.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani për menaxhimin e mbeturinave 2016-2020 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Zyrës së Bashkimit Evropian.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Zyrës së Bashkimit Evropian dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

**Pika e tetë**



**Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin përfundimtar të kërkesës së grupit të qytetarëve të lagjes “Prishtina e Re” - Zona Perëndim.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin përfundimtar të kërkesës së grupit të qytetarëve të lagjes “Prishtina e Re” - Zona Perëndim dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për anulimin e Vendimit 01, nr. 031-52761, dt. 04.03.2016, për dhënien e pëlqimit për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës “F - F” ndërmjet blloqeve “B 1” dhe “B 2” në lagjen “Lakërishta” në Prishtinë.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për anulimin e Vendimit 01, nr. 031-52761, dt. 04.03.2016, për dhënien e pëlqimit për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës “F - F” ndërmjet blloqeve “B 1” dhe “B 2” në lagjen “Lakërishta” në Prishtinë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

**Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për anulimin e Aktvendimit 07, nr. 463-651/98, dt. 19.09.1998, të Komisionit për kthimin e tokës së Kuvendit të Qytetit të Prishtinës.**

**Halim Halimi, kryesues, tha se është dashur ky material të përkthehet nga gjuha serbe në gjuhë shqipe, sepse ka nga të pranishmit që nuk e kuptojnë gjuhën serbe. Zyra ligjore të analizojë mirë nëse çështja është në gjyq dhe zhvillohet ndonjë procedurë gjyqësore dhe nuk është e përfunduar. Ne gabojmë nëse e votojmë, gjithsesi shikojeni këtë çështje.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për anulimin e Aktvendimit 07, nr. 463-651/98, dt.19.09.1998, të Komisionit për kthimin e tokës së Kuvendit të Qytetit të Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Raportimi i komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale;**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Raportimi i komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.**

**Pika e dymbëdhjetë**

**Të ndryshme.**

**Brahim Mehmetaj kërkoi nga kryesuesi që të kujdeset për mbarëvajtjen e seancës së Kuvendit. Halim Halimi, kryesues, dha sqarime, duke cekur se obligim e ka dhe e dinë se si duhet me**

vepruar. Sa i përket lëshimit të seancës, nuk e kisha lëshuar, por kanë qenë në rend dite pikat e kundërligjshme.

**Qëndron Kastrati** tha se si kryesues në mbledhje nuk je i njëjtë për të gjithë anëtarët e Kuvendit, dhe shqetësimi im është çështja e pagës. Jeni duke bërë gabim, nuk ka logjikë me pasur një votim në Kuvend komunal dhe mos me u paguar. Më vjen keq se ka anëtarë të grupeve të tjera që varen nga këto paga të vogla dhe këto janë të hyrat e tyre të vetme.

**Halim Halimi, kryesues,** dha sqarime, duke thënë se kur të doni e fusim çështjen e pagave të anëtarëve të Kuvendit, kur të doni e marrin një vendim për rritjen e pagave, mirëpo MAPL do të na e kthej si vendim i kundërligjshëm, nëse e parashohim si Kuvend.

**Qëndron Kastrati** pyeti pse nuk është bërë pagesa për mbledhjen e korrikut, kur veç e kemi votuar rendin e ditës.

**Halim Halimi, kryesues,** për pagesën e korrik unë dhe drejtori i Administratës e kemi bërë një kërkesë dhe e kemi drejtuar në MAPL para dy - tre muajve, por nuk na është kthyer përgjigje me shkrim.

Njëherësh ai informoi se shefi i GP të LDK –së është emëruar në pozitë të re dhe LDK-ja në Kuvend do të njoftojë për shefin e ri të GP të LDK-së, ndërsa anëtari për KPF do të votohet.

**Laura Zherka** u interesua të dijë se cila drejtori e ka për obligim hartimin e hartave zonale.

**Genc Bashota** dha sqarime, duke cekur se hartat zonale i përkasin Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**Laura Zherka** theksoi se detyra projektuese bëhet për një ditë. Të kemi një takim Komiteti për Urbanizëm, një detyrë projektuese që është prej 2-3 faqeve, që mund ta diskutojmë, kur mund t'i kemi të gatshme për rend dite për hartat zonale.

**Genc Bashota** theksoi se nëse ju vendosni, ne e mbajmë takimin.

**Brahim Mehmetaj** informoi se para një muaji i është dërguar një shkresë nga Agjencia Antikorrupsion, ku thuhej se jemi duke hetuar konfliktin e mundshëm të interesit në raport me funksionin publik që e ushtron. Iu kam përgjigjur shkresës, më është thënë se je duke bërë konflikt interesi, sepse je pronar dhe menaxher në kompaninë "Syri - Grup". Unë jam liruar nga ai konflikt para një muaji.

**Qëndron Kastrati** shprehu shqetësimin për funksionimin e komiteteve jo obligative, prej disa anëtarëve të grupeve të tjera, të cilët nuk po na ftojnë në asnjë takim, andaj kërkoj që të iniciohet ky problem.

**Halim Halimi, kryesues,** theksoi se ne kemi mundur edhe këto komitetet jo obligative me i paguar, disa komuna i paguajnë. Në bashkëpunim me DEMOS –in, e kemi bërë një buxhet edhe vitin e kaluar edhe tash dhe mbetet të shihet sa është vullneti.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:30.*

**Procesmbajtësja:**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**